



BASHKIA  
TIRANË

**Drejtuar: Operatorit ekonomik “Fusha” shpk**

**Adresa: Njësia Bashkiake Nr. 2, Rruga “Murat Toptani”, përballë Kinema Millenium, godina nr. 3, Pedonalja, Tiranë**

### **FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar” “Shërbimi i Pastrimit të Tiranës”, Loti IV: “Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana IV”**

**Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Shërbimi i Pastrimit të Tiranës”, Loti IV: “Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana IV”.**

**Numri i referencës së procedurës/lotit: Ref-80611-12-01-2020**

**Fondi limit në total: 2,787,613,252** (dy miliard e shtatëqind e tetëdhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e trembëdhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

**Fondi limit Loti IV: 906,755,115** (nëntëqind e gjashtë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e njëqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

**Burimi i financimit:** vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë së Tiranës.

**Kohëzgjatja e kontratës:** Afati maksimal i realizimit të shërbimit do të jetë 3-vjecar. Operatorët ekonomik të shpallur fitues (per secilin Lot) do të rinovojnë kontratat objekt të kësaj Marrëveshje Kuadër çdo 1 (një) vit.

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 25.01.2021, ora 11:00**

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 115 datë 07.12.2020.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

**1. Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk** NUIS K71401004W

Vlera e ofertës = 0 (zero) lekë.

**2. Operatori ekonomik “Pastrime Silvio” shpk** NUIS K91413010N

Vlera e ofertës = 0 (zero) lekë.

**3. Operatori ekonomik “Fusha” shpk** NUIS J61922018S

Vlera e ofertës = **861,648,872.85** (tetëqind e gjashtëdhjetë e një milion e gjashtëqind e dyzetë e tetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e dy pikë tetëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

**4. Operatori ekonomik “Korsel” shpk** NUIS J64104124G

Vlera e ofertës = **891,799,337.10** (tetëqind e nëntëdhjetë e një milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e treqind e tridhjetë e shtatë pikë dhjetë) lekë pa TVSH.

**Janë s’kualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:**

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

**1. Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk** NUIS K71401004W

- Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk ka paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik vetëm Vërtetimin e Debisë me Nr10326/1 Prot. datë 17.11.2020.

Mungesa e dokumentacionit të plotë ligjor, ekonomik dhe teknik u konfirmua nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53, pika 3 dhe pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar) si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu VII, Neni 66, pika 3, KVO e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

**2. Operatori ekonomik “Pastrime Silvio” shpk** NUIS K91413010N

- Operatori ekonomik “Pastrime Silvio” shpk ka paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik Ekstraktin e Regjistrit Tregtar si dhe ISO-t.

Mungesa e dokumentacionit të plotë ligjor, ekonomik dhe teknik u konfirmua nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53, pika 3 dhe pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar) si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu VII, Neni 66, pika 3, KVO e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “Fusha” shpk**, me adresë: *Njësia Bashkiake Nr. 2, Rruga “Murat Toptani”, përballë Kinema Millenium, godina nr. 3, Pedonalja, Tiranë*, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **861,648,872.85** (tetëqind e gjashtëdhjetë e një milion e gjashtëqind e dyzetë e tetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e dy pikë tetëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar , oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **891,799,337.10** (tetëqind e nëntëdhjetë e një milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e treqind e tridhjetë e shtatë pikë dhjetë) lekë pa TVSH, siç parashikohet në Nenin 58, pika 5 të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar).

**Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 03.02.2021**

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.